

Banka e Shqipërisë

BULETINI I BILANCIT TË PAGESAVE

Botim Tremujor

Shtator 2002

1. PAMJE E PËRGJITHSHME

Treguesit e bilancit të pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2002 reflektojnë një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave e shpenzimeve korente dhe flukseve të kapitalit.

Kështu llogaria korente në fund të tremujorit u mbyll me një deficit prej 109.1 milionë dollarësh, i cili është shkaktuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave.

Deficiti i transaksioneve korente është financuar kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit, në rreth 65 për qind, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 71.5 milionë dollarë. Pjesa e mbetur e deficitit korent është financuar nga transaksione të tjera të pidentifikuara, të cilat reflektohen në zërin “gabime dhe harresa”¹.

Tabelë 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln usd).

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	3M-III '01	3M-III '02
LLogaria Korrente	31.4	36.6	-62.3	-253.7	-65.0	-132.9	-163.1	-217.9	-82.7	-109.0
Eksporti i mallrave fob	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4	304.6	58.5	86.1
Importi i mallrave fob	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,076.4	-1,331.6	-317.7	-383.1
Bilanci tregtar	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0	-1,027.0	-259.2	-297.0
Shërbimet: Kredi	83.1	98.2	127.3	67.9	86.6	266.7	448.1	533.5	134.9	208.6
Shërbimet: Debi	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-129.3	-165.4	-430.0	-444.2	-117.2	-209.0
Të ardhurat: Kredi	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	162.5	44.1	43.9
Të ardhurat: Debi	-41.4	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-13.4	-4.1	-3.6
Transferrat private	374.1	348.9	476.0	235.7	421.3	188.4	438.6	542.6	113.1	138.9
Transferrat shtetërore	117.1	128.5	83.4	29.0	82.6	165.0	94.4	28.1	5.7	9.1
Llogaria kapitale	21.6	389.5	4.9	2.1	31.1	67.5	78.2	117.8	27.0	32.3
Llogaria financiare	24.2	-414.5	49.6	140.7	16.0	36.8	182.5	109.0	26.6	39.2
Investime direkte	53.0	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	207.3	54.9	45.0
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	-23.4	-13.0	-6.1
Kapitale të tjera	-28.7	-484.5	-40.5	93.2	-29.0	-4.4	64.5	-86.9	-21.2	0.3
Gabime dhe harresa	-44.5	7.9	54.8	142.5	69.4	131.3	15.0	136.1	58.3	66.0
Bilanci i përgjithshëm	54.9	30.6	47.0	43.8	59.4	123.5	131.9	145.0	29.2	28.5
Rezerva & zëra të lidhur me të										
Mjetet e rezervës	-54.9	-30.6	-47.0	-43.8	-59.9	-123.6	-131.9	-145.0	-29.2	-28.5
Përdor. kred. & huash nga fondi	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	12.0	5.9	0.0
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja
Financime të jashtëzakonshme
Për t'u përmendur										
Ndryshim i Rezervave	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-116.2	-42.1	-32.9
Efekt i Kursi i Këmbimit	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	1.5	23.3	-3.0

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

¹ Në mungesë të statistikave nga burimet zyrtare, statistikave të bilancit të pagesave në disa shifra përbajnë vlerësime të Bankës së Shqipërisë, për rrjedhim ajo rezervon të drejtën të revizionojë këto statistika kur të dhënat zyrtare të bëhen të vlefshme.

*Transaksionet e tregtisë së jashtme*² llogariten në rreth 469 milionë dollarë dhe përfaqësojnë në masën 42 për qind volumin e transaksioneve korente. Tregtia në mallra vlerësohet në rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën koresponduese në vitin 2001, përkatësisht me 9 dhe 25 për qind. Këtë tremujor tendenca në rritje u vërejt në të dy komponentët tregtarë, të cilët realizuan, gjithashtu, volumet më të larta për nëntëmujorin e parë të vitit.

Rritja e importeve në vlerë absolute më e lartë se ajo e eksporteve çoi në thellimin e deficitit tregtar. Borxhi tregtar vlerësohet në 297 milionë dollarë dhe mban një nivel 15 për qind më të lartë se në periudhën korresponduese të vitit paraardhës.

Ashtu si në periudhat e mëparshme edhe këtë periudhë në peshë të konsiderueshme fluksi tregtar në mallra përfaqësohet nga importi (rreth 82 për qind), gjë që flet për një ekonomi dhe treg të brendshëm të orientuar nga importi.

Bilanci i shërbimeve këtë tremujor regjistron një deficit prej 0.5 milionë dollarësh, ndërkohë që, e njëjta periudhë një vit më parë regjistroi shifra pozitive. Eksporti i shërbimeve vlerësohet në rreth 208.6 milionë dollarë dhe kjo është mundësuar kryesisht prej shërbimeve të turizmit, të cilat zënë rreth 87 për qind të kësaj shume, pjesën tjetër e përfaqësojnë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare. Importi i shërbimeve vlerësohet rreth 209.1 milionë dollarë. Në shpenzimet për importin e shërbimeve peshën kryesore e zënë shërbimet e turizmit dhe ato të transportit respektivisht me 73 dhe 15 për qind. Këto të fundit janë rritur kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë me rreth 18.7 për qind kryesisht si pasojë e rritjes së importit.

Bilanci i të ardhurave vlerësohet në nivelet e tremujorit të tretë të një viti më parë (rreth 40 milionë dollarë). Këto të ardhura përbëhen kryesisht nga të ardhurat nga investimet në formën e interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente dhe të ardhurat nga puna e punonjësve sezonalë.


² Llogaritur sipas metodikës së Bilancit të Pagesave, importi në çmim F.O.B.

Transfertat korente vlerësohen me një bilanc pozitiv prej 148 milionë dollarësh. Rolin kryesor në këtë suficit e luajnë dërgesat nga emigrantët, që për këtë tremujor, vlerësohen rreth 155 milionë dollarë amerikanë duke financuar deficitin tregtar në masën 52 për qind.

Flukset neto të kapitaleve regjistruan rreth 71.5 milionë dollarë amerikanë dhe kanë financuar rreth 66 për qind i deficitit korent. Transfertat kapitale vlerësohen rreth 32 milionë dollarë dhe llogaria financiare është mbyllur me një bilanc pozitiv prej rreth 39.2 milionë dollarë. Importi i kapitaleve është realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte, disbursimit të kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, dhe investimet e mjeteve valutore në bankat e huaja .

Flukset hyrëse në mjete valutore, në formën e kapitaleve financiare, reflektuan në rritjen e *rezervave valutore të autoritetit monetar* me 28.5 milionë dollarë.

Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE.




2. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i tretë regjistroi volumin më të lartë të transaksioneve korente për nëntëmujorin e parë të vitit 2002 (1.1 miliardë dollarë), i cili paraqitet në nivelet e

fundvitit të kaluar. Krahasuar me periudhën paraardhëse dhe atë korresponduese të një viti më parë ky volum vlerësohet i rritur respektivisht me 25.8 për qind dhe 33 për qind. Kjo rritje është shkaktuar si në të ardhurat ashtu edhe në shpenzimet korente.

Të ardhurat korente, regjistruan 503 milionë dollarë dhe vlerësohen rreth 39 për qind më të larta se tremujori paraardhës dhe rreth 33 për qind kundrejt atij korrespondues të një viti më parë. Eksporti i rritur i shërbimeve dhe transfertat korente, të cilat këtë tremujor zënë rreth 74 për qind të të ardhurave korente, janë faktorët kryesorë të rritjes.

Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL.




Shpenzimet korente regjistruan rreth 612 milionë dollarë dhe vlerësohen me një rritje prej 17 dhe 33 për qind respektivisht kundrejt tremujorit paraardhës dhe atij të njëjtë një vit më parë. Në rritjen e këtyre shpenzimeve kanë ndikuar kryesisht importet e larta të mallrave dhe shërbimeve, të cilat kanë çuar në një deficitit korent prej 109.1 milionë dollarësh. Ky deficit paraqitet në rënie prej 33 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe në rritje me 31.8 për qind kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2001.

2.1 TREGTIA E JASHTME

Tremujori i tretë i vitit realizoi volumin më të lartë të transaksioneve tregtare të zhvilluara përgjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2002. E vlerësuar në rreth 469 milionë dollarë, tregtia në mallra u rrit me rreth 25 për qind krahasuar me periudhën korresponduese në vitin paraardhës, duke regjistruar rritje në të dy komponentët tregtarë.

Grafik 3. BILANCI TREGTAR (në mln usd).



Rritja e kërkesës së brendshme u shpreh me rritje të produkteve të importit për konsum, investime dhe të importeve lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend, të cilat vlerësohen konsiderueshëm në rritje kundrejt të njëjtës periudhë në vitin paraardhës.

Importet ndihma vlerësohen rreth 10 për qind më të larta, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2001. Këtë tremujor, ndihmat në mallra ishin kryesisht në artikuj tekstilë, mallra ushqimorë dhe në makineri e pajisje, me donatorë kryesorë Greqinë dhe Italinë.

Tabelë 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJORËVE PËR PERIUDHËN '94-'01

(në mln usd).

Periudha	Eksporte	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse	Importe	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse
T1 1994	28.0	-19.7	-98.6	-29.7
T2 1994	31.2	10.0	-136.9	22.1
T3 1994	30.9	0.6	-148.2	4.0
T4 1994	51.8	67.5	-171.6	12.8
T1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
T2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
T3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
T4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
T1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
T2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
T3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
T4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
T1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
T2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
T3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
T4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
T1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
T2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
T3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
T4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
T1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
T2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
T3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
T4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
T1 2000	61.7	-5.4	-227.3	-9.1
T2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
T3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
T4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
T1 2001	78.5	26.2	-285.4	-12.0
T2 2001	87.8	11.9	-328.1	15.0
T3 2001	58.5	-33.4	-317.7	-3.2
T4 2001	79.8	36.5	-400.3	26.0
T1 2002	76.0	-4.8	-315.8	-21.1
T2 2002	72.1	-5.1	-360.1	14.0
T3 2002	86.1	19.4	-383.1	6.4

Nën këto tendenca shpenzimet në importin e mallrave kapën shifrën 383 milionë dollarë. Fluksi i importit i vlerësuar në rritje si ndaj periudhës paraardhëse (6 për qind) ashtu edhe përkundrejt të njëjtës periudhë në vitin paraardhës (21 për qind) vlerësohet, gjithashtu, më i larti i arritur për nëntëmujorin e parë të vitit 2002.

Të ardhurat nga eksporti i mallrave, këtë tremujor u vlerësuan në rreth 86 milionë dollarë dhe përfaqësojnë nivelin më të lartë të arritur përgjatë nëntëmujorit të parë të vitit. Ecuria e eksporteve i është shmatur tendencave sezonale. Ndryshe nga sa pritej, të ardhurat nga eksporti i mallrave, këtë tremujor, regjistruan rritje (rreth 19 për qind) kundrejt tremujorit të dytë të vitit, duke u vlerësuar gjithashtu, më të larta krahasuar me periudhën korresponduese në vitin 2001 (rreth 49 për qind). Rritje regjistroi si eksporti nga prodhimi i brendshëm ashtu edhe rieksperti (prodhim mall i porositur) duke ndikuar pozitivisht në ecurinë e të ardhurave nga eksporti i mallrave për këtë tremujor.

Rritja e konsiderueshme e importeve çoi në thellimin e deficitit tregtar. I vlerësuar në rreth 297 milionë dollarë borxhi tregtar u rrit me 3 për qind ndaj periudhës paraardhëse dhe 15 për qind ndaj tremujorit të tretë të vitit 2001.

Deficiti tregtar vihet re përgjatë gjithë grupmallrave me përjashtim të grupit të veshjeve të këmbëve, në të cilin vlera e shtuar në rieksperte bën që ky grupmall të regjistrojë vazhdimisht suficit.

Importet e larta në makineri e pajisje, mallra ushqimorë dhe mjete transporti cilësohen si faktorët që shkaktuan, në masën më të madhe, thellimin e deficitit tregtar, krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.

2.1.1 Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv


Aktiviteti tregtar në fushën e përpunimit aktiv përfaqëson një pjesë të rëndësishme në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me botën. Me një volum prej 117 milionë dollarësh, tregtia nga industria e përpunimit aktiv në vend përfaqësoi rreth 27 për qind të transaksioneve tregtare të zhvilluara gjatë këtij tremujori. Industria e përpunimit aktiv (prodhim mall i porositur) prezantohet përgjithësisht me aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj, organizuar në kompani të vogla dhe të mesme. Kjo industri është e përqendruar kryesisht në përpunimin e mallrave tekstilë, veshje këmbësh dhe lëkurë, të cilat së bashku zënë rreth 82 për qind në shkëmbimet tregtare të kryera prej saj. Italia përfaqëson investitorin kryesor në fushën e përpunimit aktiv në vend e ndjekur nga Greqia.

Importi i mallrave lëndë e parë për përpunim aktiv përfaqësoi në masën 15 për qind shpenzimet në importin e mallrave për këtë tremujor. Duke mbetur nën tendenca sezonale zhvillimi, importet e kësaj kategorie regjistruan rënie kundrejt periudhës paraardhëse, megjithatë, ato vlerësohen konsiderueshëm në rritje krahasuar me periudhën korresponduese në vitin 2001 (shih tabela). Me volume në rritje kanë ardhur importet në tekstile, veshje këmbësh, lëkurë dhe metale, të cilat kryesojnë importet lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend, duke zënë përkatësisht 44, 17, 13 dhe 8 për qind të volumit të importuar.

TREGTIA	Volumi (në mln usd)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
	T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2002/T2 2002	T3 2002/T3 2001
Totali i eksportit	58.5	72.1	86.1	100.0	100.0	100.0	19.4	47.3
<i>nga të cilat:</i>								
Eksport i zakonshëm	14.3	19.4	25.1	24.4	26.9	29.1	29.3	75.4
Rieksport nga përpunimi aktiv	44.2	52.7	61.1	75.6	73.1	70.9	15.8	38.2
Totali i importit	319.9	364.1	387.2	100.0	100.0	100.0	6.4	21.0
<i>nga të cilat:</i>								
Import i përkohshëm për përpunim aktiv	42.5	64.0	59.2	13.3	17.6	15.3	-7.5	39.1
Importe ndihma	2.0	3.8	2.2	0.6	1.0	0.6	-41.8	10.5

Rieksporti nga përpunimi aktiv siguroi në masën 71 për qind të ardhurat në valutë nga tregtia e jashtme në mallra. Periudha të cilën po analizojmë i është shmangur sezonalitetit që ka karakterizuar trendin e aktivitetit tregtar nga kjo industri. Kështu, i pritur në rënie, rieksporti nga industria e përpunimit aktiv në vend, këtë tremujor e rriti me rreth 16 për qind volumin e regjistruar në tremujorin e dytë të vitit duke u vlerësuar, gjithashtu, ndjeshëm në rritje ndaj realizimit në periudhën korresponduese të vitit 2001. Rritje regjistruan rieksportet në artikuj tekstilë, në veshje të këmbëve si dhe në artikuj prej metali, të cilët përfaqësojnë fluksin e eksportit nga kjo industri në masën 94 për qind.

Grafik 4. TENDENCA NË ECURINË E TREGTISË NGA FUSHA E PËRPUNIMIT AKTIV, (indeks: T1 1996=100).



Trendi rritës që karakterizon flukset tregtare në industrinë e përpunimit aktiv në vend flet për vazhdimësi pozitive të saj. Megjithatë, në nivel nëntëmujor realizimi i eksporteve nga kjo industri vlerësohet vetëm 5 për qind më i lartë krahasuar me një vit më parë. Kjo për efektet e mundshme negative, që rrjedhin nga problematika në furnizimin me energji elektrike në vend. Importi lëndë e parë për përpunim aktiv në nivel nëntëmujor vlerësohet 22 për qind më i lartë kundrejt nëntëmujorit të vitit 2001.

2.1.2 Importi dhe eksporti sipas grupmallrave

Importi tregtar³ realizoi një volum prej 385 milionë dollarësh duke u vlerësuar në rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese në vitin e kaluar, përkatësisht me 7 dhe 21 për qind.

Tendenca në rritje e importit, e vërejtur edhe në tremujorët paraardhës, flet për rritje të kërkesës së brendshme për mallra importi. Krahasuar me një vit më parë, importi regjistroi rritje përgjatë gjithë grupmallrave kryesorë me përjashtim të importeve në produkte vegjetale, për të cilat tregu vendas ka qenë kryesisht i furnizuar nga prodhues shqiptarë.

³ Në analizën e mëposhtme importi nuk përmban vlerësime të bëra nga Bilanci i Pagesave. Importi është i shprehur në vlerë C.I.F përjashtuar ndihmat.

Tabelë 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd).

HS	GRUPMALLRA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2002/T2 2002	T3 2002/T3 2001
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	6.5	10.4	9.9	2.0	2.9	2.6	-4.6	53.3
II	Produktet vegjetale	20.3	23.2	19.1	6.4	6.4	5.0	-17.8	-6.1
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	3.8	6.4	4.3	1.2	1.8	1.1	-33.2	13.0
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	28.9	31.6	36.1	9.1	8.8	9.4	14.3	25.0
V	Produkte minerale	42.5	50.1	49.6	13.4	13.9	12.9	-1.1	16.5
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	18.5	20.6	21.9	5.8	5.7	5.7	6.4	18.2
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	10.0	9.7	13.6	3.1	2.7	3.5	39.6	36.1
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	6.8	9.0	8.4	2.1	2.5	2.2	-6.2	24.4
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	3.2	4.0	4.3	1.0	1.1	1.1	6.8	37.1
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	5.2	8.0	7.4	1.6	2.2	1.9	-7.8	41.6
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	30.1	38.6	38.6	9.5	10.7	10.0	-0.1	28.2
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat, lule artificiale	9.4	13.8	12.6	3.0	3.8	3.3	-8.5	34.0
XIII	Art. prej guri, allçie, çimentoje; qeramike; qelq	13.0	14.5	16.1	4.1	4.0	4.2	10.6	23.5
XIV	Perlat; gurë e metalet e çmuar; bizhuteri; monella	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-42.2	45.0
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	29.8	34.0	37.2	9.4	9.4	9.7	9.5	25.1
XVI	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	60.9	56.4	72.2	19.2	15.7	18.8	27.9	18.5
XVII	Mjete transporti, avione, anije, pajisje shoqëruese transp.	16.0	17.8	22.1	5.0	4.9	5.7	24.3	38.4
XVIII	Instrumente e aparate optike; orë; instrum. muzikorë	6.3	2.6	2.9	2.0	0.7	0.8	13.8	-53.6
XIX	Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-1.6	7.5
XX	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	6.6	8.8	8.5	2.1	2.4	2.2	-2.9	28.7
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikitet	0.0	0.5	0.0	0.0	0.1	0.0
TOTALI		317.9	360.3	385.0	100.0	100.0	100.0	6.9	21.1

Ecuria pozitive në sektorin e bujqësisë, përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, krijoi kushte të favorshme për shtimin e prodhimit bujqësor. Ashtu si në tremujorin paraardhës edhe këtë tremujor tregu vendas në perime të freskëta dhe fruta ka qenë kryesisht i furnizuar nga prodhues shqiptarë⁴, duke çuar në rënie të importeve në produkte vegjetale. Megjithatë, industria ushqimore që përfaqëson produkte me peshë më të madhe në totalin e importeve ushqimore, ende paraqitet me deficit në sasi për furnizimin e tregut të brendshëm. Rrjedhimisht, kërkesa për importe në ushqim, pije, duhan mbeti e lartë. Shpenzimet e importit për këto produkte (përfshi këtu grupet nga I në IV të klasifikimit HS) u rritën me rreth 17 për qind krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2001. Situata e vështirë energjitike në vend ka mbajtur në nivele të larta importet në energji elektrike dhe në karburante për t'u përdorur si zëvendësues. Këtë tremujor, importi në energji elektrike përfaqësoi, në masën 25 për qind shpenzimet për importe në produkte minerale dhe u vlerësua në rënie ndaj periudhës paraardhëse (rreth 37 për qind) duke çuar në rënie të importeve në produkte minerale ndaj kësaj periudhe. Megjithatë, krahasuar me periudhën korresponduese në vitin 2001 janë importuar rreth 118 milionë kwh energji elektrike më shumë, që çuan në rritje të shpenzimeve të importit të energjisë

⁴ Nga inspektimet e bëra nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

elektrike me rreth 47 për qind. Importi në karburante vlerësohet 50 për qind më i lartë krahasuar me tremujorin paraardhës duke mbetur rreth të njëjtit nivel të regjistruar në tremujorin e tretë të vitit 2001. Ritmet pozitive që kanë karakterizuar ecurinë e sektorit të ndërtimit sollën rritje të kërkesës për importe në çimento. Këtë tremujor, këto importe përfaqësuan rreth 29 për qind të importit në produkte minerale dhe vlerësohen në rritje si ndaj periudhës paraardhëse ashtu edhe krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2001, përkatësisht me 8 dhe 22 për qind.

Importet në makineri e pajisje përfaqësuan në masën 19 për qind shpenzimet në importin e mallrave të këtij tremujori, duke mbetur faktor përcaktues në një shkallë të konsiderueshme në sjelljen e shpenzimeve në importin e mallrave. Mbulimi gjeografik i Shqipërisë me valë të operatorëve telefonikë (AMC dhe Panafon Vodafon), shtrirja gjeografike e mediave elektronike dhe vizuale si dhe nevojshmëria për zëvendësimin e rrjetit të amortizuar elektrik në vend kanë rritur kërkesën për importe në makineri e pajisje, të cilat vlerësohen në rritje si ndaj periudhës paraardhëse ashtu edhe krahasuar me tremujorin e tretë në vitin 2001.

Ecuria e eksporteve, këtë tremujor, vlerësohet pozitivisht. Të ardhurat nga eksporti i mallrave kapën shifrën 86 milionë dollarë, nga rreth 58 milionë në periudhën korrik-gusht 2001.

Struktura e eksportit dominohet nga eksportet me material porositësi, *fason* (kryesisht këpucë dhe tekstile), të cilat përfaqësuan rreth 71 për qind të të ardhurave nga eksporti i mallrave, ndërkohë që, eksporti i prodhimeve vendase kontribuoi me 29 për qind të saj. Të dy këta komponentë vlerësohen në rritje kundrejt një viti më parë: eksporti nga prodhimi i brendshëm me rreth 75 për qind dhe eksporti nga industria e përpunimit me material porositësi me rreth 38 për qind.

Mosshfrytëzimi i potencialit të brendshëm të ekonomisë mbetet një nga faktorët kryesorë për moszhvillimin e eksporteve në sektorë me potenciale të larta eksporti. Eksporti i nga prodhimi i brendshëm përfaqësohet kryesisht nga eksporte në metale (ferrokrom dhe alumin), në bimë medicinale, në duhan, në lëkurë të papërpunuar, në lëndë drusore dhe në produkte minerale. Realizimi i

eksporteve në grupmallrat e sipërpërmendur vlerësohet në rritje kundrejt një viti më parë. Megjithatë, efektin më të madh në rritje të të ardhurave nga eksporti i prodhimit të brendshëm e dha rritja e eksporteve në ferrokrom.

Tabelë 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd).

HS	GRUPMALLRA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2001	T2 2002	T3 2002	T3 2002/T2 2002	T3 2002/T3 2001
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	0.7	0.9	0.7	1.2	1.2	0.8	-19.5	-5.8
II	Produktet vegjetale	3.1	2.3	3.8	5.2	3.2	4.5	64.6	25.6
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	3.5	1.9	3.6	6.1	2.7	4.2	90.0	2.6
V	Produkte minerale	0.5	2.1	2.1	0.9	3.0	2.4	-1.9	292.7
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	0.6	0.4	0.4	1.1	0.6	0.5	2.0	-33.8
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	0.1	0.1	0.2	0.2	0.1	0.2	56.0	38.6
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	2.1	3.2	2.2	3.6	4.4	2.6	-30.8	5.9
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	2.1	2.2	2.1	3.7	3.0	2.4	-3.0	-2.2
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	0.3	0.3	0.7	0.6	0.5	0.8	114.0	113.1
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	24.4	26.0	33.3	41.8	36.1	38.6	27.8	36.1
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat, lule artificiale	15.0	20.7	22.4	25.6	28.7	26.0	8.3	49.6
XIII	Art. prej guri, alçie, çimentoje, qeramike, qelq	0.3	0.3	0.5	0.4	0.5	0.5	34.1	84.5
XIV	Perlat; gurë e metalet e çmuar; bizhuteri; monella	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	27.6	100.6
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	3.5	6.7	8.7	6.0	9.3	10.2	31.1	151.2
XVI	Makinëri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	0.7	3.3	2.9	1.1	4.5	3.3	-12.6	328.3
XVII	Mjete transporti, avione, anije, pajisje shoqëruese transp.	0.1	0.2	0.2	0.1	0.3	0.3	18.5	318.8
XVIII	Instrumente e aparate optike; orë; instrum. muzikorë	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.2
XIX	Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.4	0.0	0.1	0.7	0.0	0.1	823.6	-69.0
XX	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	0.8	1.4	1.8	1.4	1.9	2.1	35.4	116.8
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikart	0.1	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0
TOTALI		58.5	72.1	86.1	100.0	100.0	100.0	19.4	47.3

Ecuria e eksporteve të duhanit ndjek tendenca sezonale brenda vitit. Kështu, tremujori i tretë përfaqëson periudhën në të cilën regjistrohen eksportet më të larta brenda vitit. Edhe pse në rritje të konsiderueshme kundrejt periudhës korresponduese të një viti më parë⁵, eksportet e duhanit, për këtë tremujor, mbeten ende nën kuotat e regjistruara në vite.

Eksporti në bimë medicinale vlerësohet në rritje, rreth 37 për qind, ndaj tremujorit të tretë të vitit 2001.

2.1.3 Partnerët tregtarë

Tregtia me vendet e Bashkimit Europian përfaqëson në masën më të madhe fluksin tregtar të Shqipërisë me botën. Mëse 77 për qind e transaksioneve tregtare, në tremujorin e tretë të vitit 2002, u zhvilluan me vendet e Bashkimit Europian dhe vlerësohen 19 për qind më të larta krahasuar me periudhën

⁵ Gjatë vitit 2001 eksporti i duhanit u pakësua ndjeshëm për shkak të rënies së prodhimitarisë së tij si pasojë e faktorëve natyrorë.

korresponduese të një viti më parë. Të dy komponentët tregtarë vlerësohen në rritje, përkatësisht importi me 13 për qind dhe eksporti me 47 për qind.

Periudha të cilën po analizojmë nuk solli ndryshime përse i përket gjeografisë së tregtisë së jashtme. Aktiviteti tregtar i Shqipërisë mbetet i përqendruar në shkëmbime mallrash me dy shtete europiane, Italinë dhe Greqinë. Mëse 64 për qind e volumit të përgjithshëm të transaksioneve tregtare të vendit, gjatë këtij tremujori, u zhvilluan me këto dy shtete, përkatësisht 39 për qind me Italinë dhe 25 për qind me Greqinë.


Rreth 50 për qind të transaksioneve tregtare brenda grupit të Bashkimit Europian, këtë tremujor janë kryer me Italinë. Aktiviteti tregtar me Italinë regjistroi rritje në të dy komponentët e tij dhe vlerësohet 27 për qind më i lartë krahasuar me periudhën korresponduese të vitit 2001. Rritja e kërkesës së brendshme për mallra importi çoi në rritje të importeve me Italinë (rreth 20 për qind) kundrejt një viti më parë. Ndjeshëm janë rritur importet në mallra ushqimorë, në makineri e pajisje si dhe në tekstile dhe këpucë. Këto të fundit jo vetëm si lëndë e parë për përpunim aktiv por edhe me destinacion tregun e brendshëm. Kërkesa për importe nga ky vend ishte e përqendruar kryesisht në makineri e pajisje elektrike, këpucë, artikuj të veshjes, lëkurë, mallra ushqimorë, çimento, fruta, artikuj gize e çeliku (shih grafikun 6).

Italia përfaqëson tregun e parë për eksportet shqiptare. Eksporti me këtë vend realizoi 68 për qind të të ardhuarve në valutë nga aktiviteti tregtar i vendit, dhe regjistroi një rritje prej rreth 47 për qind. Në rolin e investitorit kryesor në industrinë e përpunimit aktiv në vend, eksportet kryesore me Italinë ishin kryesisht riekporte në produkte mall me porosi (tekstile dhe këpucë) si dhe në metale.

Aktiviteti tregtar me Greqinë vlerësohet 11 për qind më i lartë kundrejt një viti më parë. Importi i mallrave u rrit me rreth 8 për qind dhe eksporti me rreth 41 për qind. Shpenzimet në importe me Greqinë përfaqësojnë 27 për qind të shpenzimeve totale për importe dhe kanë qenë kryesisht për importe në, makineri e pajisje, duhan, karburante, artikuj të veshjes, gize e çelik, çimento, artikuj plastikë dhe fruta.

Produktet kryesore që kanë gjetur treg në vendin fqinj ishin kryesisht artikuj tekstilë (të prodhuar me porosi), duhan, bimë medicinale, periodikë (botime) dhe karburante, duke kontribuar në masën 16 për qind në të ardhurat nga eksporti i mallrave.

GRAFIK 6. TREGTIA NË MALLRA ME PARTNERËT KRYESORË (në milionë dollarë).



Tregtia me vendet e Rajonit⁶ zë rreth 15 për qind të totalit të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën dhe vlerësohet rreth 45 për qind më e lartë krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë. Këtë tremujor, tregtia në rajon prezantohet me 19 për qind të volumit të importuar dhe 4 për qind të volumit të eksportuar. Në importe shkëmbimet tregtare zhvillohen kryesisht me Turqinë, Kroacinë, Bullgarinë dhe Maqedoninë. Në eksporte tregtia zhvillohet kryesisht me Republikën Jugoslave (përfshihet Mali i Zi dhe Kosova) dhe me Maqedoninë.

⁶ Në këtë grupim përfshihen Bullgaria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Jugosllavia (përfshi Mali i Zi dhe Kosova), Maqedonia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia.

Në kuadrin e nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë mes vendeve të Europës Juglindore⁷ (shih box 1), pritet në të ardhmen një intensifikim i shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit. Në stadin aktual shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit, të përfshira në procesin e krijimit të zonës së lirë tregtare, janë mjaft të kufizuara.

Shkëmbimet tregtare me Turqinë, zunë 5 për qind në volumnin e përgjithshëm të transaksioneve tregtare të zhvilluara përgjatë këtij tremujori. Aktiviteti tregtar zhvillohet gjerësisht në krahun e importeve, ndërkohë që, eksportet shqiptare nuk kanë gjetur treg në këtë vend. Importi me Turqinë pësoi një rënie të lehtë rreth 2 për qind ndaj tremujorit të tretë të vitit 2001, vit gjatë të cilit importet me këtë vend, të stimuluar kryesisht nga kriza në sitemin financiar dhe zhvlerësimi i Lirës Turke, u rritën ndjeshëm. Turqia është investitor në metalurgjinë e përpunimit të metaleve në vend (Kurum Elbasan). Kështu që, në masë të konsiderueshme importohet lëndë e parë në gjysmë produkte gize e çeliku. Gjithashtu, importohen artikuj të veshjes si dhe mallra ushqimorë.

⁷ Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit është në proces nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë mes Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Rumanisë, Moldavisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, që gradualisht do të plotësohen brenda fundit të këtij viti.

Box 1. Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë të Shqipërisë në Rajon

Shqipëria, si dhe vendet e tjera të Europës Juglindore, me nënshkrimin në Bruksel të Memorandumit të Mirëkuptimit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë, në 27 qershor 2001, institucionalizoi angazhimin për t'u bërë pjesë e zonës së tregtisë së lirë në rajon. Kjo do të thotë lëvizje e lirë e mallrave dhe shërbimeve që shoqërohet me shfrytëzim më të mirë të avantazheve krahasuese të vendeve.

Objektivi kryesor i marrëveshjes është krijimi nga palët në mënyrë graduale i një zone të tregtisë së lirë gjatë një periudhe tranzitore me kohëzgjatje maksimale prej 6 vjetësh. Kjo do të thotë që pas vitit 2008, në shkëmbimin e mallrave midis vendeve pjesëmarrëse nuk do të aplikohen tarifa doganore. Objektivat specifike të marrëveshjes përmbajnë:

(i) zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet palëve dhe rritja e standardit të jetesës së popujve, (ii) eliminimi gradual i kufizimeve në tregtinë e mallrave, (iii) vendosja e kushteve të barabarta konkurruese për tregtinë e mallrave, (iv) kontribuimi në heqjen e barrierave ndaj tregtisë, në zhvillimin e harmonizuar dhe zgjerimin e tregtisë botërore, (v) krijimi i kushteve për nxitjen e mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në këto vende/në rajon, (vi) nxitja e tregtisë dhe e bashkëpunimit midis palëve me vendet e treta. Krijimi i zonës së lirë tregtare mes vendeve të rajonit prek kryesisht sektorin industrial, ndërsa sektorët e bujqësisë dhe të industrisë së mallrave ushqimorë, në shumë raste parashikojnë hapje të pjesshme e graduale ose ruajtje të regjimit aktual tregtar.

Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të intensifikojë shkëmbimet tregtare me rajonin. Gjithashtu, krijimi i një zone të lirë tregtare me një popullsi prej 55 milionësh është me interes për investitorët vendas dhe të huaj.

Shqipëria ka tashmë marrëveshje të tregtisë së lirë me Maqedoninë (aplikuar nga 1 gushti i vitit 2002) dhe Kroacinë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë), si dhe negociata në proces me Bosnje-Hercegovinën, me Jugosllavinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë dhe Moldavinë.

2.2 SHËRBIMET


Transaksionet e shërbimeve këtë tremujor regjistruan një volum prej rreth 417.6 milionë dollarësh i cili përfaqësoi rreth 37 për qind të transaksioneve korente. Ky volum vlerësohet rreth 60 dhe 50 për qind më i lartë se ai i tremujorit të dytë të vitit dhe i të njëjtës periudhë një vit më parë. Kjo rritje është mundësuar në të dy komponentët, import dhe eksport shërbimesh. Kështu eksporti (208.6 milionë dollarë) vlerësohet respektivisht rreth 1.8 dhe 1.5 herë më i lartë se periudha paraardhëse dhe ajo korresponduese e një viti më parë ndërkohë importi (209.1 milionë dollarë) paraqitet me rreth 1.4 dhe 1.7 herë kundrejt tremujorit paraardhës dhe atij korrespondues një vit më parë.

Turizmi edhe këtë tremujor mbetet komponenti kryesor i shërbimeve. Kështu, të ardhurat nga shërbimet e aktivitetit të turizmit vlerësohen rreth 183 milionë dollarë, shifër kjo rreth 2 herë më e lartë se eksporti i mallrave, ndërkohë që shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 153 milionë dollarë. Ajo që ka sjellë këtë dyfishim të të ardhurave nga shërbimi i turizmit më shumë sesa ndryshimi i shpenzimeve ditore (të cilat mund të themi se në vlerë mesatare nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të ndjeshëm) ka qenë dyfishimi i numrit të të huajve, të cilët kanë hyrë në Shqipëri në këtë tremujor për qëllime biznesi ose turizmi. Ndërsa me shpenzimet që kanë kryer shqiptarët jashtë shtetit, shkak kryesor në rritjen e tyre kanë qenë shpenzimet ditore të udhëtarëve megjithëse edhe numri i udhëtarëve paraqitet i rritur sidomos në rastin e personave që kanë udhëtuar për qëllime personale. Duhet theksuar që në këtë periudhë ka pasur rënie të numrit të ditëqëndrimit mesatar që është kompensuar mjaft mirë nga rritja e shpenzimeve ditore. Rrjedhimisht, në fund të tremujorit të tretë të vitit, bilanci pozitiv i këtyre shërbimeve vlerësohet me 29.5 milionë dollarë

Ashtu siç pritej, rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit. Importi i shërbimeve të transportit vlerësohet rreth 33 milionë dollarë ose rreth 18.7 për qind më i lartë se ai i tremujorit të tretë të vitit 2001, ndërkohë që importi i shërbimeve të sigurimit (rreth 12.4 milionë dollarë) është rritur rreth 18 për qind.

Këto kategori shërbimesh kanë dominuar mbi transaksionet e tjera të shërbimeve.

Grafik 5. BILANCI I SHËRBIMEVE.



Kategoria “shërbimet e tjera” ka regjistruar një suficit prej 8.4 milionë dollarësh dhe vlerësohet në rënie prej 32 për qind kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Kjo rënie ka ardhur kryesisht prej uljes së të ardhurave nga shërbimet qeveritare. Megjithatë, roli i tyre në zhvillimet e tregtisë së shërbimeve mbetet modest dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm.

2.3 TË ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave gjatë tremujorit të tretë regjistroi 40.3 milionë dollarë. Ky suficit vlerësohet i rritur me rreth 52 për qind dhe ka ardhur si rrjedhim i rritjes së të ardhurave hyrëse dhe i reduktimit të të ardhurave dalëse, ndërkohë që ka ruajtur të njëjtat nivele të periudhës korresponduese të vitit 2001.

Të ardhurat hyrëse regjistrojnë rreth 44 milionë dollarë dhe përfaqësohen kryesisht nga të ardhurat nga puna dhe ato të përfuara nga interesat e përfuar nga investimet e mjeteve tona valutore jashtë. Të ardhurat nga puna e punonjësve sezonalë, këtë tremujor (27 milionë dollarë) regjistruan një rritje prej 16.4 për qind kundrejt atij korrespondues të vitit të kaluar dhe 25 për qind kundrejt tremujorit paraardhës. Të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të

sistemit bankar në formën e depozitave dhe ato të përfuara nga investimet e sistemit bankar në formën e investimeve të portofolit, regjistrojnë rreth 16.5 milionë dollarë.

Ndërkohë, të ardhurat e dala jashtë regjistrojnë rreth 3.6 milionë dollarë, të cilat përfaqësohen nga interesat e paguar për depozitat e jorezidentëve në sistemin tonë bankar si dhe në formën e shërbimeve të borxhit të jashtëm.


2.4 TRANSFERTAT

Bilanci pozitiv i transfertave korente regjistroi rreth 148 milionë dollarë dhe vlerësohet i rritur me rreth 25 për qind dhe 15 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2001 dhe periudhës paraardhëse. Kjo rritje erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së transfertave hyrëse kryesisht nga të ardhurat nga emigrantët, të cilat kanë kapur shifrën 153 milionë dollarë ose 16 për qind më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe rreth 25 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit dhe 8 herë më të larta se tremujori paraardhës. Një shifër e tillë mund të konsiderohet si një tregues i besueshëm për një parashikim optimist për dërgesat e emigrantëve, të cilat, në zhvillime normale, duhet të arrijnë një shifër mbi 600 milionë dollarë për të gjithë vitin.

Transfertat shtetërore vlerësohen rreth 9 milionë dollarë dhe përfaqësohen nga ato në asistencë teknike dhe ato në formë ndihmash në mallra.

Transfertat dalëse (16.4 milionë dollarë) regjistrojnë një rritje prej rreth 2.5 herë kundrejt tremujorit pasardhës ndërkohë që vlerësohen në renie me rreth 32 për qind kundrejt periudhës korresponduese të një viti më parë.

Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE .




3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Tremujori i tretë i vitit regjistroi një fluks neto kapitalesh prej 71 milionë dollarësh. Transfertat e kapitalit regjistrojnë rreth 32 milionë dollarë, ndërkohë llogaria financiare paraqitet me një fluks kapitalesh neto prej 39 milionë dhe vlerësohet në rritje kundrejt periudhës korresponduese të vitit 2001. Kjo rritje vjen kryesisht si rrjedhojë e rritjes së detyrimeve financiare.

3.1 DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2002 u rritën me rreth 106 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 2.4 herë më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës dhe rreth 1.3 më e lartë se ajo e tremujorit të tretë e vitit 2001. Importi i këtyre kapitaleve është realizuar kryesisht prej disbursimit të kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, thithjes së investimeve të huaja direkte si dhe rritjes së investimeve në formën e depozitave të bankave dhe institucioneve financiare jorezidente në sistemin tonë bankar.

Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (në mln usd).




Investimet e huaja direkte gjatë tremujorit të parë regjistruan një fluks prej 45 milionë dollarësh dhe vlerësohen rreth 55 për qind më të larta se tremujori paraardhës ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë këto vlerësohen rreth 18 për qind më të ulëta. Kjo rënie vjen për faktin se në vitin e kaluar, në investimet e huaja direkte rol dominant kanë luajtur privatizimet e kompanive shtetërore, gjë që nuk është prezent gjatë këtij viti. Megjithatë, këto flukse kapitali mbeten një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare.

Huamarrja. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive nga jashtë duke iu shtuar borxhit të jashtëm të Shqipërisë me 60 milionë dollarë, shifër kjo rreth 3 herë më e madhe sesa tremujori korrespondues një vit më parë. Disbursimet kanë shkuar me rreth 95 për qind në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori. Vetëm 1 për qind e totalit të disbursimeve kanë shkuar në favor të sektorit “Autoritet Monetar”, ndërkohë që rreth 4 për qind e këtyre disbursimeve kanë shkuar në favor të “Sektorë të tjerë”.

Këto disbursime vazhdojnë të përfaqësohen kryesisht nga kreditë e Bankës Botërore nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit (IDA).

Grafik 8. STOKU I BORXHIT TË JASHTËM SIPAS SEKTORËVE.



Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë tremujorit të tretë 2002 regjistruan rreth 7 milionë dollarë.

Detyrimet financiare në formën e *depozitave të jorezidentëve* në sistemin bankar, për tremujorin e tretë 2002 janë rritur me 9.4 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje është rreth 16 për qind më e madhe se ajo që pësuan këto depozita në tremujorin e tretë të vitit 2001, ndërkohë që totali i depozitave të jorezidentëve në fund të këtij tremujori është rreth 1.7 herë më i madh se në fund të tremujorit të tretë 2001. Gjendja e depozitave të kësaj kategorie, në fund të muajit shtator, regjistroi shifrën 89 milionë dollarë duke ndryshuar tendencën në rënie që patën këto depozita gjatë tremujorit të dytë të vitit 2002. Vihet re një mbizotërim i depozitave në *euro*, rreth 76 për qind, pasuar nga ato në *usd* me 19 për qind.

3.2 MJETET FINANCIARE

Aktivitetet tona valutore jashtë, në fund të këtij tremujori, janë rritur me 67 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje vlerësohet 12 për qind më e lartë se ajo e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe ka ardhur si pasojë e rritjes së depozitave të sistemit bankar në bankat dhe institucionet financiare jashtë.

Rënia e theksuar e tremujorit të kaluar në mjetet financiare në formën e *depozitave të rezidentëve jashtë* u pasua në tremujorin e tretë 2002 nga një rritje prej 34 milionë dollarësh duke kapur një total prej 440 milionë dollarësh. Rritja e depozitave të publikut në sistemin tonë bankar, ndryshe nga tremujori i kaluar, kanë bërë që bankat tona të rrisin depozitat e tyre jashtë. Depozitat e kësaj kategorie gjatë tremujorit përbëhen nga ato në *usd* me 52 për qind e në *euro* me 47 për qind, që do të thotë se raporti vazhdon të jetë në favor të depozitave në *usd*.


Mjetet likuide në valutë të huaj të sistemit bankar, në fund të këtij tremujori, kanë regjistruar 29 milionë dollarë duke pësuar një rënie prej 3.7 milionë dollarësh përgjatë tremujorit. Duhet theksuar që deri në fund të tremujorit të tretë 2002 vihet re një ngjashmëri në tendencat në rritje ose në rënie përgjatë tremujorëve me ato të vitit 2001, që tregon për një ndikim sezonaliteti në ecurinë e mjeteve dhe të detyrimeve financiare të vendit.

Mjetet financiare në formën e *investimeve të portofolit* arritën në shumën 114.6 milionë dollarë duke shënuar një rritje përgjatë tremujorit prej 6.1 milionësh. Gjatë këtij tremujori, rritjen më të madhe e pësuan investimet e portofolit në *euro*, që në fund të shtatorit përbëjnë 15 për qind të investimeve të portofolit në fund të këtij tremujori.

4. REZERVAT

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja) u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me 28.5 milionë dollarë. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore me rreth 33 milionë dollarë, e cila është shoqëruar me një rënie të mjeteve në SDR me 4.5 milionë dollarë.

Grafik 9. REZERVAT E AUTORITETIT MONETAR.



Niveli i rezervave valutore në fund të vitit regjistroi 813 milionë dollarë, i cili ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.3 muaj mporte (import mallrash).